




REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-0/DPK</u>	Nr Prot B: Prot <u>01-34/AG</u>
Nr. I faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>08.01.2016</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.01.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-3954-15, për Zyrtarin e lartë, z.Nol Dedaj – Kryeshef i Ndërrmarrjes Publike, “Stacioni i Autobusëve”–Prishtinë, për shkak se ai tashmë nuk e ushtron këtë funksion publik dhe nuk gjendet fare në mesin e zyrtarëve të lartë publik të vendit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-3954-15, për Zyrtarin e lartë, z.Nol Dedaj – Kryeshef në Ndërrmarrjen Publike “Stacioni i Autobusëve” – Prishtinë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, ka filluar së trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtarit të lartë, z.Dedaj i është dërguar shkresa njoftuese nga Agjencia kundër Korrupsionit, por e cila na është kthyer ne Agjenci me porosinë nga posta se “z.Dedaj nuk gjendet ne adresën e adresuar”.

Me pastaj kemi kontaktuar pikën kontaktuese të Agjencisë kundër Korrupsion nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, dhe nga znj.Teuta Rugova – zyrtare e personelit, me e-mail zyrtar kemi marr informacion se z.Nol Dedaj nuk ushtron me detyrën e Kryeshefit Ekzekutiv në Stacionin e Autobusëve, sepse në atë pozitë tashmë Ushtrues Detyre është z.Nezir Rama.

Meqenëse kjo ka qenë pozita e cila z.Nol Dedaj e ka fut në mesin e zyrtarëve të lartë publik të vendit, atëherë pushimi i ushtrimit të këtij funksioni rrjedhimisht do të thotë edhe largim nga ky mes. Ndërkohë që nuk kemi informacione tjera se z.Dedaj ka marr ndonjë funksion tjetër që e

radhitë ate në mesin e zyrtarëve të lartë publik. Përderisa është kjo gjendje, rasti ndaj tij mbyllet, dhe mund të rihapet nëse ekzistojnë rrethanat e njëjta, në momentin kur i njëjti merr funksion të zyrtarit të lartë publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor Agjencisë kundër Korrupsionit

